



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 55, datë 20.07.2018

PËR LICENCIMIN E SH. A. UJËSJELLËS KANALIZIME POLIÇAN

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a Ujësjiellës Kanalizime Poliçan për licencim për efekt përfundimit të shtimit të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura dhe ndryshimit të emrit të shoqërisë, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatohet se:

- Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Poliçan me NUIS J69102446I është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 7, datë 03.02.2017 "Për rinovim licence Ujësjiellës Poliçan" me vlefshmëri 4 vjeçare deri në datë 02.02.2021;
- Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Poliçan me anë të shkresës Nr. 392 prot. të datës 28.06.2018, ka aplikuar pranë ERRU për licencim për arsye të shtimit të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura;
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Poliçan plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për shtimi të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura, konkretisht:
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur i plotë;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Poliçan me:

Drejtues Ligjor Klajdi Brahim
Drejtues Teknik Klajdi Brahim

2. Operatori Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Poliçan autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Poliçan;

4. Kjo licencë është e vlefshme deri më 02.02.2021;

5. Vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 7, datë 03.02.2017 "Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Poliçan" dhe nr. 23, datë 07.06.2017 "Për një ndryshim në vendimin nr.7, datë 03.02.2017 "Për licencimin e sh.a Ujësjetllës Poliçan", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI